




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.424/2022
Datë: 3 nëntor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Riza Livoreka, gjyqtar në Gjykatën, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/12/2022/GJTHFR-ADGHTHFR/nr.6/22, të datës 31.08.2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 3 nëntor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Riza Livoreka, gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pikat 2.6 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje “Këshilli”), me datë 23.05.2022 ka pranuar nga Autoriteti Kompetent kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor duke pretenduar se Riza Livoreka, gjyqtar i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 2-shkelje e detyrave të gjyqtarët, sipas këtij ligji, përfshin veprimet e mëposhtme, në qoftë se gjyqtari i kryen me dashje ose nga pakujdesia e rëndë, pikat 2.6-nuk raporton rastet e përjashtimit të mundshëm nga procedura kur kërkohet me ligj dhe 2.15- përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtoj besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Sipas pretendimit të Autoritetit Kompetent për të njëjtat shkelje të pretenduara nga ankuesi Rrjet Ballkanik i Gazetarisë Huluntuese-BIRN, si autoritet ka bërë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor me datë 27.01.2022 dhe Këshilli lidhur më këtë kërkesë kishte themeluar panelin hetimor. Për këtë rast disiplinor subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Riza Livoreka dhe paneli kishin arritur marrëveshje vullnetare për pranim të fajësisë. Këshilli me datë 20 prill 2022, ka mbajtur seancë pa prezencën dhe pas shqyrtimit dhe analizimit të marrëveshjes ka nxjerr vendim KGJK.nr.149/2022, me të cilin ka aprovuar marrëveshjen vullnetare për pranim të fajësisë.

Subjekti i hetimit gjyqtari Riza Livoreka është shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.8 dhe 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe paragrafi 5, pika 5 e Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe të njëjtit i është shqiptuar sanksioni disiplinor zvogëlim i përkohshëm i pagës në lartësi prej 40%, në kohëzgjatje prej 10 muaj.

Me tutje, Autoriteti Kompetent ka theksuar se bazuar në rregulloren 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, neni 14, par.4, e cila përcakton se “në rast së gjatë hetimit paneli hetimor gjen se gjyqtari ka kryer edhe shkelje të tjera disiplinore, ai e njofton Këshillin dhe kërkon aprovim për zgjerimin e hetimit”. Andaj duke pasur parasysh që lidhur me rastin konkret nuk ka ndonjë provë të re në lidhje me objektin që duhet shqyrtuar, pra nuk ka ndryshuar gjendja faktike, nga ajo që është paraqitur dhe transmetuar në emisionin televiziv TV dukagjini, me datë 26.01.2022 në lidhje me sjelljet e gjyqtarit të cilat janë manifestuar gjatë këtij emisioni, megjithatë si Autoritet Kompetent duke u mbështetur në nenin 8, par.2 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka kërkuar nga Këshilli fillimin e hetimit ndaj gjyqtarit Livoreka të paraqitura si në kërkesë dhe atë në pikat: Mosrespektim i parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë; Mostrajtim i barabartë i palëve në procedurë; Bërje me dije e vendimeve gjyqësore para nxjerrjes së aktgjykimit dhe mos raportim i përjashtimit të mundshëm për shkak se vajza e gjyqtarit ishte praktikante tek avokatja e palës paditëse.

Kërkesës së lartë cekur, Autoriteti Kompetent i’ ka bashkangjitur kërkesën e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Huluntuëse-BIRN dhe deklaratën e subjektit të hetimit disiplinor.

Këshilli me vendimin me numër KGJK.nr.273/2022, të datës 31 maj 2022, ka themeluar panelin për të shërbyer në lëndën disiplinore Nr.AD/KGJK/12/2022/ GJTHFR-ADGHTHFR/nr.6/22.

Paneli hetimor ja ka paraqitur Këshillit raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Pas pranimit të raportit të panelit hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, Këshilli me datë 22 shtator 2022, ka mbajtur seancë dëgjimore ku morën pjesë Kryesuesi i panelit hetimor, gjyqtari Luan Berisha dhe subjekti i hetimit disiplinore, gjyqtari Riza Livoreka dhe përfaqësuesi i tij av. Sabri Kryeziu.

Kryesuesi i panelit hetimor në seancën dëgjimore në Këshill të mbajtur me 22 shtator 2022, deklaroi se me datë 7 korrik 2022, kanë mbajtur seancën e parë jo publike, në të cilën është dëgjuar subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Riza Livoreka me përfaqësuesin e tij av. Sabri Kryeziu. Pasi kanë elaboruar faktet dhe provat është hartuar raporti me shkrim mbi faktet dhe provat e mbledhura dhe i është dorëzuar Këshillit për shqyrtim dhe vendosje. Sipas vlerësimit të panelit pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave është arritur në përfundim se për pretendimin për shkelje disiplinore për mos respektim të parimit të pavarësisë dhe paanshmërisë, për mos trajtim të barabartë të palëve në procedurë gjyqësore, kanë qenë çështje të përfunduara paraprakisht me vendimin KGJK.nr.149/2022, të datës 20 prill 2022, në bazë të marrëveshjes paraprake për pranim të fajësisë në mes të panelit dhe subjektit të hetimit gjyqtarit Riza Livoreka.

Ndërsa për pretendimet për shkelje disiplinore sa i përket bërjes me dije të vendimeve gjyqësore dhe mos raportim i përjashtimeve të mundshme bazuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve kemi mbledhur faktet dhe provat dhe të njëjtat ja kemi dorëzuar Këshillit për shqyrtim dhe vendosje.

Avokati Sabri Kryeziu, si përfaqësues i subjektit të hetimit Riza Livoreka në seancën dëgjimore të Këshilli deklaroi se e kundërshton në tërësi iniciimin e procedurës disiplinore për rasti Riza Livoreka, pasi sipas pretendimeve të tij të njëjtat shkelje disiplinore janë gjykuar dhe është nxjerr një vendimin nga Këshilli se bashku me sanksionin disiplinor të shqiptuar. Në kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore të ankuesit nuk ka asnjë rrethanë të re dhe as bazë nga neni 14, paragrafi 4 i Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Kjo pasi nuk ka ndryshim të gjendjes faktike nga ajo që është transmetuar në emisionin e televizionit KTV, andaj edhe është pengesë procedurale për të vazhduar me tutje dhe i propozoj Këshillit që kërkesën për iniciim të procedurës ta hudh si të pa lejuar.

Për ti vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore Këshilli administroi dhe vlerësoi këto prova: Raporti mbi faktet dhe provat e mbledhura të panelit hetimor i datës 22.7.2022 dhe i datës 15.08.2022 i seancave të mbajtura në këto dy data; Shkresat e datës 06 maj 2022, me numër referencë 622 drejtuar kryesuesit të KGJK-së, nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj; Shkresat e datës 10 maj 2022, e kryetarit të gjykatës Themelore në Ferizaj, për gjyqtarin subjekt i hetimit; Shkresa e datës 23 maj 2022 e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj për Kryesuesin e KGJK-se; Shkresa për hapjen e hetimit disiplinore e datës 09.06.2022; Procesverbali i seancës dëgjimore të datës 8 korrik 2022; Shkrues që mban numrin C.nr.69/18, datë protokollimi 21.1.2022, si përgjigje në ankesë; Kërkesa e bashkangjitur nga paneli për intervistim; Transkripti i seancës dëgjimore i datës 22.07.2022; Vërtetim për zonjën Vjosa Livoreka, që mban datën 25.11.2017, me numër protokollimi 1492.2017; Shkresat e dërguar nga Kastriot Berisha, përmes email-it në adresën e kryesuesit të KGJK-së; Vendimin e KGJK-së të evidentuar KGJK.nr.149/2022 dhe dosjen paraprake.

Këshilli lidhur me pretendimet e ankuesit për mos raportim të përjashtimit të mundshëm të gjyqtarit nga procedura kur kërkohet me ligj, ka konsideruar se mosveprimi i tillë nga ana e subjektit të hetimit disiplinor nuk përbën bazë për shqiptimin e ndonjë mase disiplinore për shkak se vajza e subjektit të hetimit është angazhuar si praktikante të avokatja e palës paditëse përmes Odës së Avokatëve.

Po ashtu është marrë për bazë edhe fakti se ndarja e lëndëve bëhet në mënyrë automatike përmes sistemit për menaxhimin e lëndëve - SMIL, dhe ndarja e lëndës në fjalë nuk është bërë me preferenca apo çfarëdo ndikimi nga ana e gjyqtarit veprimi i cili do të kishte për pasojë shkeljen e ndonjë norme të përcaktuar me Kodin e Etikës dhe Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Po ashtu duke marrë për bazë edhe faktin e konstatuar nga paneli hetimor, dhe të gjeturat e vet Këshillit pa dyshim konstatohet se gjyqtari në fjalë edhe para se vajza e tij nga Oda e Avokatëve të caktohej për të kryer stazhin e praktikantit tek avokatja e palës paditëse, në vazhdimësi ka trajtuar dhe trajton lëndë të cilat e njëjta i përfaqëson. Prandaj, në një rrethanë të tillë nuk mund të supozohet se lënda në fjalë për të cilën është paraqitur ankesa për subjektin e hetimit, ka mund të caktohet ndryshe nga lëndët tjera të cilat janë trajtuar nga subjekti i hetimit dhe janë përfaqësuar nga avokatja e njëjtë.


Për këto arsye, Këshilli konstatoi se pretendimi i tillë nga ankuesi nuk përbën shkelje disiplinore konform Ligjit Nr. për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 5 paragrafi 2 pika 2.6 “Nuk raporton rastet e përjashtimit të mundshëm nga procedura kur kërkohet me Ligj”.

Këshilli gjatë vlerësimit dhe analizimit të pretendimeve të tjera të ankuesit për shkelje të nenit 5, paragrafi 2, pika 2.15. “përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtoj besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit”, konstatoi se për të njëjtat është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë në mes të panelit hetimor dhe subjektit të hetimit z. Riza Livoreka. Kjo Marrëveshje është aprovuar nga Këshilli, me vendimin KGJK.nr.149/2022, të datës 20 prill 2022. Rrjedhimisht, trajtimi i këtij pretendimi tani më është konsumuar me Marrëveshjen e arritur.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 3 nëntor 2022, konstatoj se subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari Riza Livoreka, në rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/12/2022/GJTHFR-ADGHTHFR/nr.6/22, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuar në nenin 5, paragrafi 2, pika 2.6 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.424/2022, datë: 3 nëntor 2022

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Mustaf Tahiri, Kryetar i Gjykatës Themelore në Ferizaj;*
- *Riza Livoreka, Gjyqtar në Gjykatën Themelore në Ferizaj- Dega ne Kaçanik.*